



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1392/2 prot.

Tiranë, më 14. 10. 2020

V E N D I M

Nr. 140, datë 14. 10. 2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 51, datë 09.06.2020, e shtetases V. N., kundër Bashkisë Tropojë, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të bindjeve politike*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesja sqaron se është konfirmuar si nëpunëse civile pranë Bashkisë Tropojë, më datë 28.09.2016, në pozicionin e Juristes dhe Specialistes së Barazisë Gjinore e Dhunës në Familje. Më datë 20.03.2018, është emëruar në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike. Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, në krye të Bashkisë Tropojë është emëruar R. B., si përfaqësues i subjektit politik “Partia Socialiste”. Me emërimin e R. B. në krye të Bashkisë Tropojë, ankuesja pretendon se ndaj saj ka nisur një sjellje diskriminuese për shkak të bindjeve politike të kundërta me të.

Sipas ankueses, trajtimi i diferencuar ka nisur nga ana e R. B. dhe punonjësve të emëruar prej tij, duke iu shmangur kontaktit me të. Në periudhën që ai ka qënë duke konfirmuar mandatin e Kryetarit të Bashkisë Tropojë në gjykatë, ankuesja ishte me leje vjetore. Për shkak të mbarëvajtjes së punës dhe në respekt të Kryetarit të ri të Bashkisë, ajo ka paraqitur kërkesë pranë Burimeve Njerëzore, për ndërprerjen e lejes dhe shfrytëzimin e saj në një moment të dytë.

¹ Për shkak të anëtarësimit në subjektin politik “Partia Demokratike e Shqipërisë”, vërtetuar me anë të Vërtetimit Nr. 5 prot., date 05.06.2020, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, Dega Tropojë.

Pavarësisht miratimit nga ana e Burimeve Njerëzore, kërkesat në vijim për shfrytëzimin e lejes vjetore janë refuzuar.

Në vijim ankuesja sqaron se, ka evidentuar se Kryetari dhe persona që nuk ishin pjesë e Bashkisë Tropojë, filluan të largonin nga puna punonjësit në kundërshtim me legjislacionin *“Për nëpunësin civil”*. Nga momenti i emërimit të R. B., sipas ankueses janë larguar nga puna dhe zëvendësuar nga punonjës të tjerë, rreth 95 persona. Në këtë situatë dhe referuar përshkrimin të punës së saj, për këshillimin e drejtuesit dhe hartimin e dokumentacionit ligjor, ankuesja ka kërkuar disa herë të komunikojë me R. B. dhe ta informojë se largimet nga puna nuk po bëhen mbështetur në legjislacionin në fuqi. Pavarësisht faktit që ankuesja nuk arriti të takohet me Kryetarin dhe duke qënë se zëvendëskryetarët e Bashkisë ishin pjesë e procedurave të emërimeve dhe largimeve nga puna, u ka shprehur atyre disponibilitetin e saj për të bashkëpunuar, në mënyrë që të respektohen procedurat e parashikuara në legjislacion. Në përgjigje të bashkëpunimit të ofruar, sipas ankueses, zëvendëskryetarët i janë drejtuar me shprehjen: *“...ligji jemi vetë dhe nuk e di pse na keni pritur këtu, kur e keni ditur se do vijmë ne, ju duhet të iknit vetë dhe mos të na fusni ne për t’ju hequr nga puna”*. Përsa më sipër dhe në përmbushje të detyrave të saj funksionale, ankuesja i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë me një memo, për ta informuar mbi paligjshmëritë e akteve administrative. Gjithashtu edhe në komisionet ku ankuesja ka marrë pjesë, ka shprehur pakënaqësitë e saj lidhur me parregullësitë në procedurat e rekrutimeve apo largimeve nga puna.

Në vijim, nga ana e eprorëve u vendos që të gjithë punonjësit, veç atyre të emëruar rishtas, të firmosnin në momentin që paraqiteshin apo largoheshin nga puna. Gjithashtu, bëheshin kontrole të befasishme dhe të herëpashershme për prezencën në punë. Kjo procedurë e paformalizuar me një urdhër apo dokument tjetër, sipas ankueses, ndiqej vetëm për punonjësit që kishin qënë pjesë e Bashkisë përpara emërimit të Kryetarit të ri. Pas kontrolleve të ushtruara, ankuesja pretendon se ka patur raste kur ajo ka qënë brenda zyrave të Bashkisë dhe i është hequr dita e punës pasi nuk është gjetur në zyrën e saj. Për këtë, ajo është vënë në dijeni vetëm në momentin që ka marrë pagën, pasi nuk është informuar më parë nga personat përgjegjës. Në këto kushte, ka kërkuar kopje të shkresës me anë të së cilës i është hequr dita e punës, por nuk i është vënë në dispozicion.

Sipas ankueses, situatat e diskriminimit kanë vijuar në çdo hap të ushtrimit të detyrës së saj nga ana e Kryetarit të Bashkisë dhe zëvendëskryetarëve. Një prej tyre është edhe refuzimi nga ana e Kryetarit të Bashkisë për të firmosur deklaratat e mbrojtjes për çështje të ndryshme gjyqësore dhe për punonjësit e larguar nga puna. Këto deklarata pasi dërgoheshin për firmë tek kryetari, i cili refuzonte ti nënshkruante, i kalonin juristëve të institucionit të ndryshuara me anë të e-mailit nga ana e zëvendëskryetarëve, Z. I. dhe K. R., duke i detyruar t’i firmosnin duke mos qënë dakord. Kjo pasi, ato përmbanin fakte të cilat nuk qëndronin (p.sh. njoftimi i punonjësve). E ndodhur në këtë situatë, ankuesja pretendon se një prej specialisteve të sektorit juridik, znj. B. I.,

është detyruar të jap dorëheqjen nga pozicioni i punës. Gjithashtu, V. N. sqaron se për shkaqet e cituara më sipër, janë detyruar të japin dorëheqjen edhe punonjës të tjerë të institucionit.

Në vijim ankuesja ka sqaruar se, që në momentin e emërimit të R. B. në krye të Bashkisë Tropojë është parë tendenca për largimin e punonjësve nga detyra për shkak të bindjeve politike. Fakt ky, që sipas V. N. vërtetohet me veprimet e ndërmarra nga ana e R. B., i cili sapo është emëruar në detyrë, me anë të Urdhrit nr. 157, datë 20.06.2019, ka kërkuar dosjet e personelit që mbanin detyrën e përgjegjësve të sektorëve dhe drejtuesve të drejtorive përkatëve. Sipas ankuses, dosjet e tyre janë kërkuar nga ana e Kryetarit, me synimin për të gjetur ndonjë shkelje në to dhe për të larguar nga puna këta punonjës. Gjithashtu, pretendohet që dosjet e tyre janë kontrolluar edhe nga persona të tjerë, jashtë ambjenteve të institucionit, të cilët nuk janë punonjës të Bashkisë Tropojë.

Largimi i punonjësve të Bashkisë Tropojë për shkak të ristrukturimit, sipas ankuses nuk qëndron, pasi të gjitha veprimet në kundërshtim me legjislacionin, janë kryer për të larguar punonjësit me bindje të kundërta politike me Kryetarin dhe për të emëruar punonjës të tjerë. Gjithashtu, ankuesja pretendon se, pavarësisht faktit që pas ristrukturimit ekzistonin pozicione ku ajo dhe punonjësit e tjerë të larguar, mund të emëroheshin, nga ana e Bashkisë Tropojë nuk është parë e arsyeshme, pasi synimi ishte largimi dhe zëvendësimi i tyre me punonjës të rinj.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ankuesja ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rivendosjen e marrëdhënieve të punës në një pozicion të ngjashëm.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të*

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës Nr. 51, datë 09.06.2020, të shtetases V. N. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresave me nr. 763 prot., datë 18.06.2020 dhe nr. 1145 prot., datë 10.08.2020, është kërkuar nga ana e KMD informacion dhe dokumentacion provues Bashkisë Tropojë.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR 413 406 955 AA, datë 18.06.2020 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga punonjësja Z. I, pra Bashkia Tropojë ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar si nga punonjësja e këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Në përgjigje përsa më sipër, Bashkia Tropojë me anë të shkresës³ Nr. 3383/1 prot., datë 14.08.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me ju, duke ju dhënë mundësinë e verifikimit të dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj dhe jeni të mirëpritur që të vini e të bëni verifikimet përkatëse, pasi për arsye të volumit të madh të punës dhe punonjësit janë me pushime, ne momentalisht e kemi të pamundur t’iu vëmë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.”*

2. Përsa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 1145/2 prot., datë 21.08.2020 Komisioneri i ka ridërguar kërkesën për informacion Bashkisë Tropojë, duke i njoftuar që brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e shkresës të paraqesin parashtrimet mbi çështjen në fjalë, sa i përket:

³ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1145/1 prot., datë 18.08.2020

- Pretendimeve të subjektit ankues.
- Kopje të procedurës së ndjekur për largimin nga puna të V. N.
- Kopje të dosjes personale të V. N.
- Kopje të vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit, nëse ka.
- Informacion dhe kopje të dosjes personale (aktit të emërimit, arsimimit, eksperiencës në punë etj.), lidhur me punonjësin që e ka zëvendësuar V. N. në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Juridik.
- Informacion dhe kopje të dosjes personale (aktit të emërimit, arsimimit, eksperiencës në punë etj.), të punonjësve të diplomuar në Drejtësi.
- Informacion nëse ka patur punonjës të tjerë të Bashkisë Tropojë të cilët janë larguar si pasojë e ristrukturimit të Institucionit. Nëse po, kopje të akteve të largimit të tyre nga puna.
- Kopje të strukturave organizative të Bashkisë Tropojë përpara dhe pas ndryshimeve të pësuar.
- Relacionin përkatës, lidhur me arsyet e ndryshimit të strukturës së Bashkisë Tropojë.
- Informacion dhe kopje të akteve të mbajtura nga ana e Komisionit të ngritur për Ristrukturimin e pozicioneve të punës në ndryshimin e strukturës.
- Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Tropojë.

Në vijim, Bashkia Tropojë, pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

3. Në kushtet që nga ana e Bashkisë Tropojë, nuk u morr asnjë masë për plotësimin e informacionit të kërkuar, KMD, referuar nenin 32/2⁴ dhe 33/13⁵ të Ligjit nr. 10221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, vendosi⁶ që Bashkia Tropojë, të gjobitet në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lekë, për mosdhënien e informacionit të kërkuar. Gjithashtu, në pikën 3 të vendimit me gjobë parashikohej se: *“Dërgimi i informacionit të kërkuar nga KMD, brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja dijeni e Vendimit për sanksionin me gjobë, sjell shfuqizimin e tij.”*

Në përgjigje përsa më sipër, Bashkia Tropojë, me anë të shkresës⁷ nr. 1229/2 prot., datë 22.09.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: *“...Ju bëjmë me dije se V. N. e cila ka mbajtur detyrën e Përgjegjëses së Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike me Vendimin nr. 81,*

⁴ Në nenin 32/2, të tij ka përcaktohet qartë se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

⁵ Neni 33/13, i ligjit të sipërcituar, ka përcaktuar se: *“Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë”: ...b) personi juridik nga 60.000 deri në 600.000 lekë.*

⁶ Me Vendimin Nr. 104, datë 10.09.2020

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 484 prot., datë 24.03.2020

datë 21.05.2020 është larguar nga shërbimi civil si shkak i ristrukturimit të institucionit, vendi i punës “Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike” me Struktura e re Organike është shkruar. Në zbatim të ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësit civil” dhe të VKM nr. 125 date 07.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civil” është shikuar mundësia e sistemimit në vende të tjera pune brenda institucionit dhe në njesitë e vartësisë në përshtatje me arsimin përkatës dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara në VKM nr.142 date 12.03.2014 , por nuk ka qënë e mundur dhe vendimi i largimit ka dalë në përputhje me ligjislacionin në fuqi. Sqarojmë se ndaj V. N. dhe ndaj asnjë punonjësi nuk është ushtruar presion dhe as nuk ka pasur diskriminim ndaj tyre ashtu si pretendon zonja në fjalë. Çdo procedure që ndjekur dhe dokument i dosjes së V. N. është bashkëlidhur kësaj shkresë”.

Në përfundim, Bashkia Tropojë vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e mëposhtëm:

- Informacion mbi një pjesë të pretendimeve të subjektit ankues.
 - Kopje të strukturave organizative të Bashkisë Tropojë përpara dhe pas ndryshimeve të pësuar.
 - Kopje të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Tropojë.
 - Kopje të procedurës së ndjekur për largimin nga puna të V. N.
 - Kopje të dosjes personale të V. N.
 - Kopje të vlerësimeve të punës të subjektit ankues për tre vitet e fundit.
4. Përsa më sipër, duke qënë se nga ana e Bashkisë Tropojë u vu në dispozicion të një pjesë e dokumentacionit të kërkuar, Komisioneri me Vendimin nr. 138, datë 14.10.2020, shfuqizoi vendimin e mëparshëm të sanksionit me gjobë dhe vijoi procedurat e mëtejshme të shqyrtimit të ankesës së V. N.
5. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet e-mailit datë 12.10.2020, ankuesja vuri në dispozicion të Komisionerit, prova dhe fakte shtesë, si dhe kopje të kërkesë padisë së paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, më datë 01.07.2020.

Bazuar në kërkesë padinë e V. N., paraqitur kundër institucionit të Bashkisë Tropojë dhe Komisionit të Ristrukturimit të Bashkisë Tropojë, Komisioneri u vu në dijeni të faktit se, në objekt të saj, ankuesja ka kërkuar ndër të tjera: “...Konstatimin e faktit të diskriminimit ndaj paditëses V. N., nga ana e palës së paditur Bashkisë Tropojë, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura, duke më kthyer në pozicionin e mëparshëm të punës pranë palës së paditur”. Pra, pretendimet për diskriminim për shkak të bindjeve politike, ankuesja i ka bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

Po ashtu, në citim të bazës ligjore, ankuesja i referohet, ndër të tjera, Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2012 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana që janë paraqitur përpara Komisionerit, bëhen prezent edhe në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, ku ankuesja ka pretenduar ndër të tjera se: *“...unë paditësja pretendoj se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2019, me ardhjen në detyrë të kryetarit të ri të Bashkisë Tropojë, i cili është përfaqësues i forcës politike “Partia Socialiste”, u ekspozua ndaj meje një trajtim diskriminues për shkak të bindjes politike...”*.

Juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen.

Në kontekst të sa më sipër, në rastin e ankueses, të njëjtat fakte e rrethana janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor; atëherë konform nenit 36, paragrafi 3, i Kodit të Procedurës Civile, prevalon shqyrtimi dhe vendimmarrja e këtij të fundit.

Përsa më sipër, pavarësisht dokumentimit të bindjeve politike të ankueses, në kushtet kur kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si dhe në mbështetje të paragrafit 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet: “Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të bindjeve politike.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar), nenin 90, pika 3 e Kodit të Procedurës Administrative, të ndryshuar, si dhe referuar neneve 12-13, nenit 19, nenit 21, pika 1, nenit 32, pika 1, gërma a), nenit 33, pikat 1, 3, 5, 7 dhe 10, si dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën e hetimit të ankesës Nr. 51, datë 09.06.2020, të shtetases V. N., pasi çështja e parashtruar në ankesën e mësipërme, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)